

Martesa e fëmijëve

Martesa e fëmijëve është një shkelje e tmerrshme e të drejtave të njeriut, që u grabit vajzave perspektivat e tyre afatgjata arsimore dhe shëndetësore. Një vajzë e martuar që fëmijë është dikush potenciali i së cilës nuk do të përmbushet. Përderisa shumë prindër dhe komunitete duan më të mirën për bijat e tyre, ne duhet të punojmë së bashku t'i japim fund martesave të fëmijëve.

Dr. Babatunde Osotimehin, Drejtor Ekzekutiv, UNFPA

Kam një motër më të vogël. Kurrë nuk do t'i kërkoja të martohej e re. Mbase kur të bëhet njëzet vjeç. Ajo duhet ta shijojë jetën. Kur martohej, nuk e gëzon jetën.

– Fëmijë e martuar, 16 vjeç në kohën e intervistës

MARTESAT E FËMIJËVE

Martesa e hershme ose martesa e fëmijëve është bashkimi zyrtar ose jo i dy personave, kur të paktën një prej tyre është nën 18 vjeç.¹ Duke u mbështetur në faktin e të qenit fëmijë, fëmijët e martuar janë konsideruar si të paaftë për të dhënë pëlqimin e plotë, do të thotë se martesat e fëmijëve duhet të konsiderohen si një shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijës. Normat e martesës së fëmijëve janë të ulëta në Shqipëri, por ato janë gjetur si praktika në mesin e romëve, si dhe në disa komunitete të izoluar rurale.

Martesa e fëmijëve është një fenomen gjinor që prek vajzat dhe djemtë në mënyra të ndryshme. Në përgjithësi, numri i djemve në martesat e fëmijëve në mbarë botën është dukshëm më i ulët se ai i vajzave. Ndërsa fëmijë-vajza të martuara janë të prekura edhe nga dhuna në familje dhe abuzimi seksual brenda marrëdhënieve të pabarabarta dhe, nëse janë shtatzëna, shpesh kalojnë ndërlikime gjatë shtatzënisë dhe lindjes, pasi trupat e tyre nuk janë të gatshme për të lindur fëmijë. Pasi martohej, si djemtë, edhe vajzat shpesh detyrohen ta braktisin arsimimin për të hyrë në fuqinë punëtore dhe/ose për të marrë përsipër përgjegjësitë brenda shtëpisë.

Traktate, konventa dhe programe të ndryshme ndërkombëtare për veprim adresojnë martesat e fëmijëve. Këto përfshijnë: Konventën mbi Pëlqimin për Martesë, Moshën Minimale për Martesë dhe Regjistrimin e Martesave (1962), Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (1979), Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), dhe Platformën e Pekinit për Veprim të vitit 1995 (i cili pasoi Konferencën e Katërt Botërore të OKB-së për Gratë). Këto instrumente ndërkombëtare mbulojnë shfuqizimin e zakoneve dhe traditave të dëmshme të dhunës kundër vajzave, pëlqimin për martesë, moshën e martesës, regjistrimin e martesës dhe lirinë për të zgjedhur bashkëshortin/en. Ky dokument përmbledhës faktesh jep informacion në lidhje me çështjen e martesës së fëmijëve në Shqipëri dhe ofron rekomandime që synojnë adresimin e çështjes. Ai përfshin një rishikim të legjislacionit kombëtar dhe ratifikimin nga shteti të standardeve të ndryshme ndërkombëtare për çështjen, një analizë të praktikave ekzistuese dhe qëndrimeve ndaj martesës së fëmijëve, dhe informacione statistikore rreth shkallës së përhapjes së praktikës. Metodologjia për këtë studim përfshiu një përmbledhje të kuadrit ligjor dhe materialet ekzistuese në lidhje me martesat e fëmijëve në Shqipëri, si edhe intervista me fëmijë të martuar dhe ekspertë që punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe të grave.

REKOMANDIMET

- Dispozita në Kodin e Familjes që u jep gjykatave vendore të drejtën të miratojnë martesat e personave nën moshën 18 vjeç duhet të përcaktojë një limit moshe dhe Kodi Penal duhet të rishikohet për të përfshirë një sërë masash në lidhje me martesat sipas ligjit zakonor (ose bashkëjetesës) që përfshijnë fëmijët. Në Kodin Civil, Kodin e Familjes, Ligjin për Shërbimin Civil dhe në ligje të tjera duhet të adresohet vakumi ligjor që rregullon lindjet nga martesat e fëmijëve.
- Duhet të rritet ndërgjegjësimi për pasojat nga martesa e fëmijëve midis hartuesve të politikave, shoqërisë civile dhe udhëheqësve të tjerë të grupimeve të ndryshme, me qëllim që kjo praktikë të adresohet në mënyrë strategjike. Duhet të mbështetet hartimi i politikave me të dhëna statistikore të sakta dhe të ndara sipas gjinisë dhe moshës për martesat, shkurorëzimet, lindjet dhe shëndetin e fëmijëve dhe nënave. Duhet të rritet ndërgjegjësimi për pasojat e martesave të hershme edhe midis prindërve, fëmijëve dhe të rinjve që jetojnë në komunitetet ku martesa e fëmijëve praktikohet gjerësisht.
- Duhet të adresohen shkaqet e vërteta dhe burimi i martesave të fëmijëve midis romëve. Martesa e fëmijëve nuk është një ngjarje e izoluar. Ajo është e lidhur me problemet e tjera sociale që hasin familjet romë, të tilla si: vështirësitë ekonomike, mungesa e strehimit të përshtatshëm dhe mungesa e aksesit në shërbimet arsimore dhe shëndetësore.
- Duke pasur parasysh nivelin e ulët të ndërgjegjësimit për planifikimin familjar dhe çështjet e shëndetit riprodhues midis romëve dhe komuniteteve të tjera të rrezikuara, ekziston nevoja për veprime të koordinuara ndërmjet aktorëve kombëtarë dhe lokalë në krijimin e mekanizmave për zbatimin e strategjive të hartuara në vend, përfshirë Strategjinë e fundit Kombëtare të Sigurimit të Kontraceptivëve. Kjo strategji synon të sigurojë që burrat dhe gratë të mund të zgjedhin dhe aksesojnë metoda moderne kontraceptive dhe shërbime të planifikimit familjar të cilësisë së lartë.

KONTEKSTI LIGJOR & KOMBËTAR

Shqipëria është një vend anëtar i Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës. Ajo është palë ose me ratifikim, ose si aderuese e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF), Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (dhe Protokollit Opsional) dhe Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

LEGJISLACIONI KOMBËTAR

Ligji më i fundit për Fëmijët, Ligji Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës i 2010-ës përputhet me Konventën e OKB mbi të Drejtat e Fëmijës (që Shqipëria ka ratifikuar në vitin 1992) dhe e përcakton fëmijën si "çdo person i lindur gjallë, i cili është nën moshën 18 vjeç".² Ligji Kuadër përcakton gjithashtu të gjitha të drejtat dhe mbrojtjen që një fëmijë ka të drejtë të ketë dhe emëron mekanizmat dhe institucionet që janë përgjegjëse për

Legjislacioni në Shqipëri është shumë i mirë në letër, por çalon zbatimin e tij. Kjo nuk ndodh për arsye të politikë-bërësve, por të atyre që e zbatojnë atë. Është një çështje e nivelit të ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve. (Zyrtar qeveritar)

garantimin e realizimit të këtyre të drejtave. Këto janë Këshilli Kombëtar dhe Agjencia Kombëtare për

Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, të ngritura në vitin 2010. Ligji gjithashtu parashikon krijimin e njësisë për mbrojtjen e fëmijëve në nivel rajonal dhe lokal, për të shërbyer si njësi primare për rastet e shkeljeve të të drejtave të fëmijëve.

Sipas Kushtetutës, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. I njëjti nen përcakton se çdo fëmijë ka të drejtën e mbrojtjes nga dhuna dhe shfrytëzimi që "mund të dëmtojë shëndetin, [. . .] ose të vërë jetën e saj dhe zhvillimin e saj normal në rrezik."³

KUSH MUND TË LIDHË MARTESË?

Sipas Kodit të Familjes, moshë minimale për martesë në Shqipëri është 18. Megjithatë, i njëjti nen i Kodit të Familjes përcakton se një gjykatë vendore mund të miratojë martesën në një moshë më të hershme "për shkaqe me rëndësi" (për shembull, kur një vajzë nën moshën 18 vjeç është shtatzënë, apo burri i ardhshëm është një emigrant i cili do të të donte të lidhte një martesë me një person nën moshën 18 vjeçare). Në një rast të tillë, nuk është e përcaktuar moshë minimale. Të gjitha martesat duhet të bazohet në pëlqimin e lirë të dy bashkëshortëve të ardhshëm dhe duhen regjistruar në një zyrë të gjendjes civile.⁴

Legjislacioni aktual ka mangësi në lidhje me dy çështje kryesore: fëmijët e prekur nga gjakmarrja dhe martesat e fëmijëve. Këto të dyja nuk janë pjesë e legjislacionit. (Aktivist i OJQ)

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë përcakton se një person arrin zotësi të plotë juridike kur ai ose ajo arrin

moshën 18 vjeç. Kodi specifikon, megjithatë, se, në qoftë se një vajzë martohet para moshës 18 vjeçare, ajo automatikisht fiton aftësinë juridike.⁵ Aftësia juridike i jep personit disa të drejta dhe detyrime ligjore, për shembull, për të lidhur kontrata, për të marrë trajtim mjekësor pa pëlqimin e prindërve dhe për të regjistruar lindjen e fëmijëve.

Kodi Penal nuk kriminalizon martesën e fëmijëve. Ka vetëm një referencë në lidhje me "Detyrimin [. . .] për të filluar ose vazhduar bashkëjetesën [. . .], i cili dënohet me gjobë ose deri në tre muaj

burgim".⁶ Në vitin 2010 nuk është ndjekur penalisht asnjë rast i tillë.⁷ Marrëdhënia seksuale me një të mitur nën moshën 14 vjeç është një vepër penale, me një dënim prej shtatë deri në 15 vjet burgim, ndërsa marrëdhënia seksuale e detyruar me forcë me një të mitur 14-18 vjeç dënohet nga pesë deri në 15 vjet burgim.

PLANIFIKIMI FAMILJAR & TË DREJTAT RIPRODHUESE

Siç përcaktohet me ligj, të drejtat për kujdes shëndetësor të barabartë dhe jodiskriminues, efikas dhe cilësor janë parime kyçe të sistemit të kujdesit shëndetësor.⁸

Sipas Ligjit për Shëndetin Publik, shërbimet esenciale shëndetësore publike përfshijnë shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe shërbimet shëndetësore për nënat dhe të miturit. I njëjti Ligj parashikon kujdesin shëndetësor për nënat dhe të miturit gjatë shtatzënisë, gjatë lindjes dhe pas lindjes, pavarësisht nga aftësia e tyre për të mbuluar shpenzimet.⁹

Të drejtat e shëndetit riprodhues rregullohen me një ligj të veçantë, që lidhet me dhënien e shërbimeve këshillimore mbi çështjet e shëndetit riprodhues, duke siguruar parandalimin dhe trajtimin e infeksioneve seksuale të transmetueshme (IST), si edhe aborte të sigurta.¹⁰

Në Shqipëri, kontracepsioni u legalizua në vitin 1992, shumë shpejt pas rënies së komunizmit. Para kësaj ishte jashtëzakonisht e vështirë të gjendeshin kontraceptivë në vend. Kontraceptivët jepen falas në klinikat shtetërore. Sigurimi i aksesit ndaj kontraceptivëve mbetet prioritet për Ministrinë e Shëndetësisë.¹¹ Së fundmi, me ndihmën e UNFPA, u lançua edhe Strategjia e re Kombëtare për Sigurimin e Kontraceptivëve për periudhën 2012-2016.¹²

Sipas Anketës Demografike dhe Shëndetësore për vitin 2008-2009, 86.4 përqind e femrave aktualisht të martuara të moshës 15-19 vjeç kishin përdorur një metodë të kontracionit në një moment të caktuar, ndërsa 32.6 për qind kishin përdorur një metodë moderne të kontracionit. Pak më shumë se gjysma e femrave aktualisht të martuara (54.7 për qind) të grupmoshës 15-19 vjeç përdornin një metodë të planifikimit familjar, ndërsa vetëm 12.9 për qind përdornin metoda moderne, ku prezervativi maskullor ishte metoda më e përdorur (9.4%).¹³ Megjithatë, shumica e grave të reja të martuara (41.8%) po përdornin metoda tradicionale të planifikimit familjar, veçanërisht tërheqjen (40.8%).

Sipas ekspertëve të shëndetit riprodhues dhe planifikimit familjar, niveli i ulët i përdorimit të metodave moderne kontraceptive lidhet me incidencën e IST-ve, nivelin e aborteve, ndërkohë që kanë implikime negative në treguesit e përgjithshëm të shëndetit të nënës dhe fëmijës, sidomos midis popullatave më vulnerabel si romët.

Afërsisht 2 për qind e të gjitha grave të moshës 15-19 vjeç kishin lindur të paktën një fëmijë, ndërsa 23.6 për qind e grave të martuara të moshës 15-19 vjeç kishin të paktën një fëmijë të lindur.¹⁴

Që nga 2009, rreth 3 për qind e femrave të grupmoshës 15-19 vjeç kishin filluar lindjen e fëmijëve. Kjo përqindje është më shumë se tri herë më e lartë në zonat rurale se sa në zonat urbane (3.8 për qind krahasuar me 1.2 për qind). Është gjithashtu afërsisht katër herë më e lartë midis vajzave që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor, se ato që kanë përfunduar arsimin e mesëm (4.4 për qind krahasuar me 1.2 për qind).¹⁵ Në vitin 2008, 3.2 për qind e të gjitha aborteve ishin kryer nga gratë nën moshën 20 vjeç (270 nga një total prej 8335).¹⁶

MARTESAT E FËMIJËVE NË SHQIPËRI

Martesa e fëmijëve në Shqipëri është një çështje komplekse. Varfëria, mungesa e vlerës që sjell edukimi i vajzave, izolimi gjeografik, përjashtimi social, trafikimi dhe emigrimi janë të gjithë faktorë që nxitin martesën e fëmijëve sot në Shqipëri, po ashtu si qëndrimet ndaj seksualitetit të grave dhe rolit të tyre në shoqëri. Në të njëjtën kohë, nga ana e saj, martesa e fëmijëve brenda komuniteteve të caktuara i forcon këto trende. Kjo për të rinjtë e

Ne nuk e dimë nëse martesa e fëmijëve është vërtet problem në Shqipëri. Politikëbërja mbështetet në të dhëna; për sa kohë që nuk ka të dhëna, ne nuk mund ta adresojmë këtë çështje. (Zyrtar qeveritar)

nënprodukt i çështjeve të tjera madhore të tilla si: përjashtimi social me bazë etnike, diskriminimi, varfëria, shfrytëzimi dhe puna e fëmijëve. Një përmbledhje e studimeve të pakta ekzistuese tregojnë se martesa e fëmijëve në Shqipëri praktikohet më së shpeshti në mes të grupit etnik rom. Ndërkohë që martesa e fëmijëve ndodh edhe në disa komunitete shqiptare, që jetojnë në zona jashtëzakonisht të izoluar, të varfra, rurale. Martesat që përfshijnë fëmijët nuk janë të regjistruara dhe, për rrjedhim, nuk njihen ligjërisht. Kjo do të thotë se mungojnë të dhënat e sakta statistikore rreth këtyre grupeve të popullatës.

MARTESA E FËMIJËVE TEK SHUMICA E SHQIPTARËVE

Martesa e fëmijëve ka qenë praktikuar në dy dekadat e fundit në disa komunitete që jetojnë në zona jashtëzakonisht të largëta, rurale, malore, ku mentaliteti patriarkal takohet me varfërinë. Këtu praktika përfshin ekskluzivisht vajzat nën moshën 18 vjeç. Djemtë hyjnë në martesë në një fazë më të vonshme të jetës, në përgjithësi në mes të 20-tave dhe 30-tave. Në ditët e sotme, martesat e hershme janë më pak të zakonshme, edhe pse ekzistojnë ende.

Në këto komunitete, martesat lidhen me shkuesi nga familjet dhe vajzat nuk mund të shprehen për zgjedhjen e bashkëshortit. Dominimi mashkullor luan një rol të rëndësishëm. Babai merr vendimin, ndërsa nëna e vajzës nuk mund të thotë fjalën e saj për këtë çështje, por vetëm shpreson që vajza e saj të jetë me fat.

Vajza pret shansin që të dalë jashtë. Ajo mezi pret propozimin që të thotë "Po." (Aktivist i OJQ)

Vajzat që jetojnë në këto fshatra të largta nuk e dinë se kanë zgjedhje të tjera të mundshme, duke pasur parasysh se shumica e tyre nuk kanë udhëtuar asnjëherë jashtë fshatit. Sipas një raporti mbi të drejtat e fëmijës botuar nga Aleanca Shqiptare e Fëmijëve, shumë vajza në këto

komunitete malore braktisin shkollën në moshën 12-13 vjeçare, në mënyrë që të marrin në dorë punët familjare në shtëpi dhe të përgatiten për martesë.¹⁷

Përderisa vajzat mbahen në izolim nga shkolla dhe jeta shoqërore, duket se martesa është për to alternativa më e mirë.

Martesat e fëmijëve në zonat e largëta rurale ndjekin një model të veçantë. Vajzat fejojnë në moshën 13-15

Përveç frikës se "askush nuk do ta [dojë] vajzën time kur ajo të rritet", familja shpreson se "sa më shpejt që të martohet, do të kemi një gojë më pak për të ushqyer". (Aktivist i OJQ)

vjeçare. Dasma bëhet pak vite më vonë, pas së cilës vajza shkon në shtëpinë e burrit. Përderisa burrat janë përgjithësisht emigrantë dhe jetojnë në vende të tjera, ata shpesh i lënë nuset e reja me familjen e tyre dhe kthehen në vendin e emigrimit. Burri zakonisht e viziton Shqipërinë dy herë në vit.

Braktisja e shkollës, zakonisht para përfundimit të arsimit të detyrueshëm (për shumicën) dhe para përfundimit të shkollës fillore (për romët) është parashikues i martesës së fëmijëve. Ajo mund të ndodhë para apo pas martesës dhe është një vendim i marrë nga prindërit, i rrënjësor në besimin se "shkolla nuk është e ardhmja". Prindërit nuk e shohin të ardhmen e vajzës së tyre përtej të qenit një bashkëshorte, zonjë shtëpie dhe nënë. Braktisja e shkollës është raportuar për të dy gjinitë në vitet e fundit të arsimit të detyrueshëm, por për arsye të ndryshme. Djemtë kanë prirje të braktisin shkollën që të hyjnë në tregun e punës, ndërsa vajzat e braktisin që të përgatiten për martesë.

Disa raporte nga aktivistë të OJQ-ve të intervistuar në këtë studim tregojnë se, në dekadat e fundit, këto martesa kanë ushqyer edhe fenomenin e trafikimit. Mundësia për të pasur një dhëndër të pasur është kaq tërheqëse, sa që familja e nuses së ardhshme është e gatshme të japë pëlqimin për martesën, edhe pse ata dinë shumë pak për dhëndrin e tyre të ardhshëm, i cili në fakt mund të jetë trafikant.

Këto familje ishin të varfra, të painformuara, të joshura nga "dhëndri i pasur dhe i dashuruar" që mund të paguante për vajzën e tyre. Ata mendonin: "Ai duhet ta dojë shumë atë, përderisa edhe paguan". (Aktivist i OJQ)

MARTESAT E FËMIJËVE MIDIS ROMËVE NË SHQIPËRI

Kam një motër më të vogël. Kurrë nuk do t'i kërkoja të martohet e re. Mbase kur të bëhet njëzet vjeç. Ajo duhet ta shijojë jetën. Kur martohesh, nuk e gëzon jetën.

(Fëmijë e martuar, 16 vjeç në kohën e intervistës)

Nuk ka shifra të sakta zyrtare për popullsinë rome në Shqipëri. Në vitin 1995, Grupi Ndërkombëtar i të Drejtave të Pakicave vlerësoi se numri i romëve në Shqipëri ishte midis 90.000 dhe 100.000.¹⁸ Jeta për romët në Shqipëri është shënuar nga papunësia, të ardhura të ulëta, varfëria dhe nivele të ulëta të arsimit.¹⁹ Studimet tregojnë se vajzat rome priren të martohen në një moshë shumë të re dhe të bëhen nëna më herët se grupet e tjera etnike. Një studim në vitet 2002-2003 tregoi se moshë mesatare e martesës për vajzat rome ishte 15.5 vjeç, ndërsa moshë mesatare e nënave në lindjen e fëmijës së tyre të parë ishte 16.9 vjeç. Në vitin 2011, 31 për qind e vajzave rome 13-17 vjeçare ishin të martuara ose të lidhura.²⁰

Kam parë fëmijë romë të martohen që në moshën 13 vjeç. Asgjë nuk është parashikuar në ligj nëse ndodh kjo. (Aktivist i OJQ)

Tabela 1 Moshë mesatare e martesës gjatë periudhës së tranzicionit (pas-1990)²¹

	Roma	Popullsia totale
Meshkuj	18.2	28.3
Femra	15.5	23.3

Tabela 2 Moshë mesatare në lindjen e fëmijës së parë²²

	Romët		Popullësia totale	
	Para 1990	Pas 1990	Para 1990	Pas 1990
Meshkuj	21.4	19.2	24.6	20.4
Femra	18.9	16.9	20.1	18.2

Studimet ekzistuese kanë gjetur se faktorët kryesorë shtytës të martesave të fëmijëve janë vlerat kulturore, varfëria, frika e prindërve për rrëmbimin e fëmijëve dhe prostitucionin, dhe edukimi i kufizuar mbi martesën dhe planifikimin familjar.²³ Rezultatet e martesës së fëmijëve dhe lindjes së fëmijëve, të raportuara nga studimet në dispozicion, përfshijnë nivele të ulëta të arsimit dhe nivele të larta të divorcit. Divorci i çon gratë në më shumë varfëri dhe përjashtim social për veten, familjet dhe fëmijët e tyre. Kjo mund të rezultojë në përdorimin e seksit si një strategji për mbijetesë dhe një mekanizëm për përballimin e varfërisë.²⁴ Përdorimi i metodave për kontrollin e lindjeve është i ulët midis romëve (10%) dhe nivelet e abortit janë të larta.²⁵

Ndërsa varfëria është një faktor madhor që ndikon në martesat e fëmijëve mes romëve, vlerat, besimet dhe qëndrimet e tyre ndaj asaj që duhet konsideruar e nderhme, morale dhe e pastër janë po aq të rëndësishme. Rritja fizike konsiderohet si një tregues i gatishmërisë për të hyrë në martesë, më shumë se sa thjesht moshë aktuale e fëmijës. Prindërit shqetësohen se, kur fëmija të arrijë moshën e pjekurisë, ai ose ajo do të fillojë të krijojë lidhje dhe të hyjë në marrëdhënie seksuale. Prindërit atëherë organizojnë martesën për t'u siguruar se vajza nuk do ta humbë virgjërinë dhe për të shmangur turpin që do të sillte kjo mbi nderin e familjes në qoftë se do të ndodhte. Në shumë raste, prindërit e detyrojnë vajzën të martohet me djalin me të cilin ajo është lidhur.

Kur vajzës i vijnë menstruacionet e para, ajo shihet si një grua, e gatshme tashmë për t'u martuar. (Advokues i të Drejtave të Fëmijëve)

Martesa e fëmijëve në mes romëve ndikon si mbi djemtë, ashtu edhe mbi vajzat. Në komunitetet rome janë të zakonshme dy lloje martesash të hershme. Më të shpeshta janë martesat e rregulluara (me shkuesi), sapo fëmija konsiderohet gati për t'u martuar (rreth moshës 12-14 vjeç tek femrat dhe 14-16 vjeç tek meshkujt). Lloji i dytë është martesa me arratisje, ku çifti vendos të martohet pa miratimin e prindërve të tyre. Martesat rome regjistrohen shumë rrallë.

Kodi i Familjes përcakton se në rast se lindin fëmijë nga vajza nën moshën 18 vjeç, "nëna minore mund ta njohë mëmësinë e fëmijës në zyrën e gjendjes civile."²⁶ Megjithatë, fëmijët që lindin nga

Nuk ka gjëra të mira kur martohesh fëmijë. Ne kemi bërë një gabim duke u martuar në këtë mënyrë. Më pas ndjehesh keq. Ne ishim të rinj, nuk e menduam gjatë atëherë. (Fëmijë Rome e martuar, moshë 14 vjeç)

martesat e fëmijëve Rome zakonisht nuk regjistrohen, ose regjistrohen si fëmijë të prindërve të vajzës, pra

gjyshërve.²⁷ Ndërkohë që kjo bën të mundur që fëmijët e lindur nga martesat e fëmijëve të marrin dokumente identiteti dhe të kenë akses në shërbimet publike, veçanërisht në shëndet dhe arsim, kjo fsheh faktin se fëmija është i lindur nga një martesë e fëmijëve jo e ligjshme.

Martesat e fëmijëve nuk janë të zakonshme në të gjitha komunitetet rome në Shqipëri. Ato ndodhin kryesisht në komunitetet më të marxhinalizuara, të cilët flasin vetëm gjuhën rome dhe janë të organizuar në familje të mëdha, të zgjeruara. Diskriminimi ndaj tyre ndjek dy akse: qëndrimi i popullatës shumicë shqiptare dhe mjedisi ligjor dhe i politikave, të cilët nuk marrin në konsideratë nevojat specifike të këtij grupi.

Fëmijët romë që martohen, zakonisht vazhdojnë ciklin e varfërisë në të cilin u lindën dhe, përderisa martesat e tyre janë të paligjshme, është e vështirë për ta që të vazhdojnë arsimimin dhe të sigurojnë strehim të përshtatshëm dhe punësim. Martesat e fëmijëve shpesh nuk zgjasin dhe një çift mund të ndahet dhe të rimartohet pas ndarjes.

PRAKTIKA NË ADRESIMIN E MARTESAVE TË FËMIJËVE

Futja në kurrikul e edukimit seksual. OJQ-të që punojnë me komunitetet e përjashtuara nga pikëpamja sociale raportojnë se futja e edukimit seksual në kurrikulën e detyruar shkollore është e dobishme për rritjen e ndërgjegjësimit. Aktivistët e OJQ-ve kanë drejtuar orë mësimore në klasë për të mbështetur mësuesit në rritjen e vetëdijes për edukimin seksual dhe çështjet e planifikimit familjar. Megjithatë, kjo lloj ndërhyrjeje është efektive vetëm për fëmijët që shkojnë në shkollë. Fëmijët romë, në veçanti, nuk mund të arrihen nëpërmjet shkollës, pasi ato priren ta braktisin atë para përfundimit të arsimit të detyrueshëm. Ndaj duhen lloje të tjera ndërhyrjesh për të arritur tek fëmijët që braktisin shkollën, për t'i informuar ata mbi çështjet e seksualitetit dhe shëndetit riprodhues.

Ndërhyrjet në komunitet. Ndërhyrjet në komunitet kanë sjellë disa rezultate pozitive në Shqipëri, duke përfshirë ndërmjetësuesit e shëndetit dhe udhëheqësit e komunitetit, që kanë dhënë mbështetjen e tyre. Megjithatë, ata janë sfiduar nga çështjet komplekse ekonomike dhe sociale me të cilat përballen njerëzit me të cilët ata punojnë, si edhe qëndrimet e komunitetit dhe ngurrimi për t'u angazhuar dhe mungesa e një qasjeje sistematike.

Fokusi tek fëmijët e martuar. Një lloj tjetër ndërhyrjeje është puna direkte me fëmijët e rrugës, disa prej të cilëve kanë lindur nga martesat e fëmijëve dhe, në të njëjtën kohë, puna me prindërit e tyre për t'i dhënë informacion për praktikën e prindërimit, zhvillimin e fëmijëve dhe planifikimin familjar.

ÇËSHTJE KRYESORE (TË PËRGJITHSHME)

Ndonëse ligjërisht martesë mund të lidhet vetëm mes dy personave mbi moshën 18 vjeç, fëmijët lidhen në martesë përpara kësaj moshe. Ligji nuk parashikon se çfarë masash duhen marrë në këto raste, përtej ndjekjes së mundshme penale për marrëdhënie seksuale me një të mitur nën moshën 14 vjeç, ose marrëdhënie seksuale me dhunë me një të mitur të moshës 14-18 vjeç.

Martesa e fëmijëve nuk është trajtuar drejtpërdrejt si një çështje avokacie nga OJQ-të, agjensitë dhe/ose OJQ-të rome. Ato janë përqendruar më shumë në punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve, mbrojtjen nga dhuna dhe përqindjet e braktisjes së shkollës, duke hamendësuar se këto janë rreziqet kryesore për fëmijët.

Ka një mungesë të të dhënave statistikore të sakta për martesat e fëmijëve.

CITIME

Përveç kufirit të moshës së martesës, legjislacioni shqiptar nuk parashikon ndonjë masë për të parandaluar martesën e fëmijëve. [Duhet] të merren masa të qarta ligjore, [duhet] të emërohen autoritetet zbatuese, [dhe këta] duhet të bashkërendojnë veprimet e tyre. (Aktivist i OJQ)

Përjashtimi nga pjesa tjetër e shoqërisë dhe fiksimi me modelet e vjetra janë arsytet e martesave të fëmijëve. Ndërprerja e arsimit është një tjetër. Nëse fëmijët shkojnë në shkollë rregullisht, do të kenë më shumë mundësi për një cikël normal të jetës. (Përfaqësues i një OJQ-je rome)

Një mënyrë për të identifikuar rastet është të gjejmë personat që kanë braktisur shkollën dhe t'i pyesim për arsytet që e kanë braktisur. Megjithatë, kjo është e vështirë, sepse nuk dihet me siguri sa është numri i fëmijëve romë, pasi mund të mos jenë të regjistruar. (Advokues i të Drejtave të Fëmijëve)

ÇËSHTJE KRYESORE (SPECIFIKE PËR ROMËT)

Problemet social-ekonomike me të cilat përballen romët janë komplekse dhe të ndërlydhura. Ato përfshijnë: mungesën e arsimit, mungesën e punësimit, probleme strehimi, mungesën e regjistrimit dhe mungesën e aksesit në shërbimet shëndetësore.

Pranimi i martesës së fëmijëve lidhet me vlerat e të rinjve dhe të rriturve. Besimi se martesë e fëmijëve është e nevojshme për të ruajtur nderin nuk mund të ndryshojë duke imponuar vlera të tjera si p.sh.: se shëndeti dhe shkollimi i grave është më i rëndësishëm.

Ndërgjegjësimi për metodat e planifikimit familjar dhe shëndetin riprodhues mbetet i ulët midis romëve të martuar që fëmijë.

CITIME

Është një gjë tjetër të adresosh martesat e fëmijëve midis romëve. Janë të nevojshme masa specifike. Është i nevojshëm një plan i tërë. Duhet të mendoni për shkollimin, për të gjetur punë, trajnime profesionale. Është një histori tjetër martesë e fëmijëve në komunitetet e shumicës. (Zyrtar qeveritar)

Njerëzit tanë martohen herët. Nuk mund t'u besosh vajzave, se ato mund të fillojnë një lidhje ose të bien në dashuri. Është më mirë që ato të martohen. (Fëmijë rome e martuar, 17 vjeç)

Kështu janë rritur [Romët] [përgjatë] në breza. Kështu janë rritur edhe gjyshërit e tyre. (Aktivist i OJQ)

Anëtarët e komunitetit rom kanë filluar të përdorin metoda të planifikimit familjar. Burrat janë më rezistentë ndaj përdorimit të tyre. Ata nuk duan që gratë e tyre të përdorin metoda të planifikimit familjar. Ndaj gratë i përdorin ato në fshehtësi, pa e ditur burrat e tyre. Ato kanë frikë nga kontraktivët oralë, por preferojnë injeksionet që merren një herë në disa muaj. (Aktivist i OJQ)

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I TË DHËNAVE

Popullsia e përgjithshme:	3,195,000 (llogaritja e 2010) ²⁸
Jetëgjatësia në lindje:	77 (llogaritja e 2010) ²⁹
Jetëgjatësia mesatare në lindje për periudhën 2005-2008:	72.1 për burrat; 78.6 për gratë ³⁰
Përqindja e popullsisë nën 15 vjeç e vitit 2009:	23.4 për qind (747,436 në total) ³¹
Përqindja e popullsisë e moshës 15-19 vjeç:	9.4 për qind (301,266 në total) ³²
Popullsia nën nivelin kombëtar të varfërisë:	12.4 për qind ³³
Shkalla e papunësisë:	13.8 për qind (2009) ³⁴
Përqindja e analfabetizimit të rinjve:	100 për qind (2010). ³⁵
Shpenzimet shëndetësore për frymë në vit (2010):	US\$ 241 ³⁶
Grupet kryesore etnike:	Shqiptarë, Grekë, Maqedonas, Malazez, Vllenj, Roma, dhe Egjiptianë ³⁷
Fetë kryesore në Shqipëri:	Muslimanë, Ortodoksë, Katolikë dhe Bektashinj ³⁸
Gjuhët kryesore:	Shqip ³⁹

STATISTIKAT E MARTESAVE TË FËMIJËVE

Nëse nuk citohet ndryshe, të gjitha të dhënat në këtë seksion janë marrë nga Studimi Demografik dhe Shëndetësor 2008-2009.⁴⁰

Tabela 3 Martesat sipas moshës së nuses (2008)⁴¹ dhe moshës së dhëndrit (2008)⁴²

Numri i përgjithshëm i martesave në 2008	Moshë e nuses (vjeç)		Moshë e dhëndrit (vjeç)	
	Nën 15	Deri në 19	Nën 15	Deri në 19
21290	0 (0%)	5945	0 (0%)	237 (1.1%)

Moshë mesatare në martesën e parë në vitin 2008 ishte 23.1 për femrat dhe 28.1 për meshkujt.⁴³

Tabela 4 Përqindja e femrave/meshkujve të martuar përpara moshës 18 vjeçare, sipas grupmoshës (2008-2009)

Moshë	% e grave martuar përpara moshës 18 vjeç	% e burrave martuar përpara moshës 18 vjeç
15-19	n/a	n/a
20-24	9.6	0.0
25-29	14.0	1.6
30-34	12.1	0.5
35-39	7.5	1.2
40-44	8.2	0.6
45-49	7.0	0.9
Total	9.4	0.8

Tabela 5 Përqindja e femrave/meshkujve të moshës 15-19 aktualisht në martesë sipas grupmoshës (2008-2009)

Age	% e femrave 15-19 vjeç të martuara/ në martesë	% e meshkujve 15-19 vjeç të martuar/ në martesë
15-19	7.4	1.0

Të dhënat ekzistuese tregojnë se numri i martesave të fëmijëve ishte më i ulët mes personave të lindur përpara mesit të viteve '70 në krahasim me ata adoleshencë e të cilëve përkoi me tranzicionin e vendit (fillimi i viteve '90) nga regjimi komunist drejt ekonomisë së tregut (personat e moshës 25-34 në kohën e Studimit Demografik dhe të Banesave). Sipas të njëjtave burime, numri i martesave të fëmijëve mes personave të lindur në dy dekadat e fundit tregon një prirje në rënie.

Shumë më tepër femra se meshkuj janë martuar përpara moshës 18 vjeç, ose ishin të moshës 15-19 vjeç dhe aktualisht në lidhje martesore. Ndërkohë që pothuajse një në dhjetë femra të moshës 20-49 vjeç të përhira në Anketën Demografike dhe Shëndetësore kishte lidhur martesë para moshës 18 vjeç, më pak se 1 për qind e meshkujve kishte bërë të njëjtën gjë. Nga Studimi Demografik Shëndetësor del se femrat dhe meshkujt në zonat urbane priren të martohen më vonë se bashkëmoshatarët e tyre në zonat rurale, ndërkohë që femrat dhe meshkujt në Tiranën urbane shfaqin prirjen ta shtyjnë martesën, në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë.⁴⁴ Mbizotërimi i martesave të fëmijëve ishte më i lartë mes meshkujve dhe femrave që kishin mbaruar vetëm arsimin 8-vjeçar ose fillor dhe atyre që u përkisnin kuintileve më të ulëta, të dyta ose të mesme të pasurisë.

Norma e fertilitetit sipas moshës për 1000 gra të grupmoshës 15-19 vjeç është 17.⁴⁵

Tabela 6 Lindje të gjalla sipas moshës së nënës (2008)⁴⁶

Numri i përgjithshëm i lindjeve të gjalla në 2008	Moshë e nënës
	15-19 vjeç
36251	1805 (5%)

¹ Një fëmijë është "çdo qenie njerëzore nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç përveç rasti kur, sipas ligjit të zbatueshëm për fëmijën, mosha madhore arrihet më herët". Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës e Kombeve të Bashkuara (1989), e disponueshme në: <http://www2.ohchr.org/english/law/crc.htm> (aksesuar më 29 maj 2012).

² Neni #3 I Ligjit Kuadër për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës (2010), e disponueshme në: <http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Ligj:10347:04.11.2010> (aksesuar më 15 qershor 2012). Kodi i Familjes, Civil dhe ai penal nuk kanë përcaktime për fëmijën apo të rinjtë.

³ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, (1998), Neni 54. E disponueshme në: http://www.mpcs.gov.al/dpshb/images/stories/files/Kushtetuta_E_Republikës_së_Shqipërisë.pdf (aksesuar më June 2012).

⁴ Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë (2004). e disponueshme në: http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/3_3_2_kodi_familjes_1942_1.pdf (aksesuar më 15 qershor 2012).

⁵ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë (2001), Neni #3. I disponueshëm në: <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/un/pan014893.pdf> (aksesuar më 15 qershor 2012).

⁶ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (2004). I disponueshëm në: <http://legislationline.org/documents/section/criminal-codes/country/47> (aksesuar më 15 June 2012).

⁷ Ministria e Drejtësisë. Vjetari Statistikor 2010, I disponueshëm në: http://www.justice.gov.al/spaw2/uploads/files/File/Vjetari_Statistikor2010.pdf (aksesuar më 15qershor 2012).

⁸ Ministria e Shëndetësisë. Gjendet në <http://www.moh.gov.al/images/ligje/2.pdf> (aksesuar më 30 shtator, 2012).

⁹ LIGJI Nr. 10 138 (Datë 11. 05. 2009) 'Për Shëndetin Publik. Sipas neneve 78 dhe 83, pika 1 e Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave', Neni # 7 dhe 54. I disponueshëm në: <http://www.moh.gov.al/faqet/ligje/en/For%20the%20Public%20Health.pdf> (aksesuar më 31 July 2012).

¹⁰ Ministria e Shëndetësisë. Gjendet në <http://www.moh.gov.al/images/ligje/14.pdf> (aksesuar më 30 shtator, 2012).

¹¹ UNFPA (2011) 'Advanced Analysis of Albanian Demographic and Health Survey 2008-2009 Data', UNFPA, Tirana, p.89.

¹² Ministria e Shëndetësisë. I disponueshëm në <http://www.moh.gov.al/index.php?module=2&item=449> (aksesuar më 31 korrik 2012).

¹³ INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik (2010) *Vrojtimi Demografik dhe Shëndetësor i Shqipërisë 2008-09*, INSTAT, Tirana, p. 67. DHS u krye mbi një kampion prej 7999 familjesh: 7584 gra dhe 3013 burra.

¹⁴ *Ibid.*, p.58.

¹⁵ *Ibid.*, p.62

¹⁶ World Health Organization (2012), Regional Office for Europe. European Health for All Database (rifreskuar korrik 2012), I disponueshëm në: <http://data.euro.who.int/hfad/> (aksesuar më 6 shtator 2012).

¹⁷ Aleanca Shqiptare e Fëmijëve (2012) 'Raport i shkurtër mbi Çështjet Madhore të Situatës së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri', Aleanca e Fëmijëve Shqiptare, Tirana, p. 9.

¹⁸ OSCE (n.d.) 'Strategjia kombetare për përmirësimin e kushteve të jetesës së romëve', OSCE, Tirana, p. 7.

¹⁹ De Soto H., S. Beddies and I.Gedeshi (2005) 'Roma and Egyptians in Albania: From social exclusion to social inclusion', Banka Boterore, Washington D.C., cituar në Qendrën për Studime Ekonomike dhe Sociale (2011) 'Hartëzimi i Fëmijëve Romë në Shqipëri', Qendra për Studime Ekonomike dhe Sociale, Tirana, p. 6.

²⁰ *Ibid.*, p. 15.

²¹ De Soto H., S. Beddies, and I.Gedeshi (2005) *op. cit.*, p. 28.

²² *Ibid.*, p. 28.

²³ *Ibid.*, p. 28.

²⁴ *Ibid.*, p. 33.

²⁵ *Ibid.*, p. 27.

²⁶ Kodi i Familjes së Republikës së Shqipërisë (2004). Article #176. I disponueshëm në: http://www.minfin.gov.al/minfin/pub/3_3_2_kodi_familjes_1942_1.pdf (aksesuar më 18 August 2012).

²⁷ Tamo, A. dhe Th. Karaj (2007) 'Situata arsimore e fëmijëve romë në Shqipëri', p. 30. Human Development Center, Albania. Raporti studimor financiar nga Unicef & Save the Children.

²⁸ INSTAT. Popullësia më 1 janar, e disponueshme në: www.instat.gov.al (hapur më 18 qershor 2012).

²⁹ UNICEF (2010) 'Statistikat e Shqipërisë', e disponueshme në: http://www.unicef.org/infobycountry/albania_statistics.html (aksesuar më 18 qershor 2012).

³⁰ INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik (2010), *op. cit.*, fq.1.

³¹ INSTAT. (2009). Shqipëria në shifra 2010, e disponueshme në: www.instat.gov.al (aksesuar më 18 qershor 2012). *Ibid.*

³² *Ibid.*

³³ World Bank. (2012). Shqipëria, e disponueshme në: <http://data.worldbank.org/country/Shqipëria> (aksesuar më 18 qershor 2012).

³⁴ *Ibid.*

³⁵ UNICEF (2010), *op. cit.*

³⁶ World Bank (2012) 'Shqipëria', e disponueshme në: <http://data.worldbank.org/indicator/SH.XPD.PCAP> (aksesuar më 9 korrik 2012).

³⁷ Qendra për Studimet Ekonomike dhe Shoqërore (2011), *op. cit.*, fq.5.

³⁸ INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik (2010), *op. cit.*, fq.1.

³⁹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998), Neni 14. E disponueshme në:

http://www.mpcs.gov.al/dpshb/images/stories/files/Kushtetuta_E_Republikes_se_Shqipërisë.pdf (aksesuar më 18 qershor 2012)

⁴⁰ INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik (2010) *op. cit.* fq.90.

⁴¹ INSTAT. Martesat e klasifikuara sipas seksit dhe grupmoshës për vitet 1990 – 2008, e disponueshme në: www.instat.gov.al (aksesuar më 18 qershor 2012).

⁴² *Ibid.*

⁴³ INSTAT. Moshë mesatare e martesës sipas seksit, e disponueshme në: www.instat.gov.al (aksesuar më 18 qershor 2012).

⁴⁴ INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik (2010) *op. cit.* fq.90

⁴⁵ INSTAT, Instituti i Shëndetit Publik (2010), *op. cit.*, fq.53. Norma e fertilitetit sipas moshës shprehet si numri i lindjeve të grave në një grupmoshë të dhënë për 1000 gra të kësaj grupmoshe.

⁴⁶ INSTAT. Lindjet e gjalla sipas grupmoshës së nënës për vitet 1990 – 2008, e disponueshme në: www.instat.gov.al (aksesuar më 18 qershor 2012).

MESAZHET KYÇE

Kur një vajzë e shtyn kohën e martesës, përfitojnë të gjithë. Një vajzë që martohet me vonë ka më shumë gjasa të qëndrojë në shkollë, në punë dhe të ardhurat e saj të ri-investohen për familjen. Ç'është më e rëndësishmja, një vajzë që martohet më vonë është më e fuqizuar dhe e gatshme të zgjedhë nëse, kur dhe sa fëmijë të ketë. Kur investohet tek vajzat, të gjithë përfitojnë: familjet e tyre, komunitetet, dhe më e rëndësishmja, vetë vajzat.

Mosveprimi në lidhje me martesat e fëmijëve ka kosto të madhe. Është koha për politikë-bërësit, parlamentarët, komunitetet, familjet dhe të rinjtë ta adresojnë këtë çështje nga fillimi. Le të krijojmë një botë ku çdo shtatzëni është e dëshiruar, çdo lindje është e sigurt dhe potenciali i çdo të riu është plotësuar. Vajzat le të jenë vajza.

Martesa e fëmijëve shkel të drejtat e vajzave, u mohon atyre fëmijërinë, ndërpret arsimimin e tyre, rrezikon shëndetin e tyre, dhe kufizon mundësitë e tyre. Asnjë arsye kulturore, fetare, ose ekonomike për martesën e fëmijëve nuk mund të justifikojë dëmin që u sjellin këto martesë vajzave të reja dhe potencialit të tyre. Një vajzë duhet të ketë të drejtën të zgjedhë atë me të cilin ajo do të martohet dhe kur. Prindërit duan më të mirën për fëmijët e tyre, ndaj dhe duhet të mbështesin zgjedhjet e vajzave të tyre dhe vendimet për t'u martuar.

UNFPA po punon me qeveritë dhe partnerët në të gjitha nivelet e shoqërisë për të ofruar programe të gjithanshme që adresojnë nevojat e vajzave të rrezikuara dhe të martuara, duke siguruar akses në jetën e përditshme, mbështetje sociale dhe programe shëndetësore, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues. Qëllimi përfundimtar është që t'i jepet fund martesës së fëmijëve në këtë brez dhe të zhvendosen qëndrimet kulturore për të mbrojtur të drejtat e vajzave.

ÇFARË DUHET BËRË PËR TË THYER HESHTJEN MBI MARTESAT E FËMIJËVE?

T'i kushtojmë vëmendje më të madhe situatave me të cilat ballafaqohen vajzat e martuara dhe vajzat në rrezik ndaj martesës së fëmijëve, si dhe të advokojmë fuqimisht për të drejtat e tyre. Martesa e fëmijëve nuk është e mirë për vajzat apo për zhvillimin. Bota nuk mund të përballojë të shohë se si çdo ditë shpërdorohen të drejtat, shëndeti dhe potenciali i mijëra vajzave.

Të nxisim investimet që të ngremë aftësitë dhe mundësitë e vajzave adoleshente, sidomos për arsimim. Arsimimi i vajzave, veçanërisht i mesëm, i ulët dhe i lartë, është faktori i vetëm më i rëndësishëm që lidhet me moshën në martesë. Vajzat veçanërisht kanë nevojë për mbështetje sociale dhe akses në programet që ofrojnë aftësi për jetën, shkrim e këndim, mjete jetese dhe informacione dhe shërbime për shëndetin seksual dhe riprodhues, të tilla si: planifikimi familjar dhe shërbime shëndetësore për të shpëtuar jetën e nënës.

TË INVESTOJMË PËR VAJZAT ADOLESHENTE!

Investimet duhet të ofrojnë platforma për vajzat në rrezik për të zhvilluar aftësitë e tyre për jetën dhe për t'u dhënë njohuri kritike shëndetësore, për të marrë shërbime sociale, përfshirë shëndetin seksual dhe riprodhues dhe parandalimin e HIV-it, për të fituar aftësi profesionale dhe për punë, si dhe për të pasur miq dhe mentorë.

Vajzat e martuara kanë nevojë për strategji të veçanta që ofrojnë akses në arsim, aftësitë për jetën e në shëndet, përfshirë ShSR dhe parandalimin e HIV dhe mundësi për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri. Programet për shëndetin e nënës duhet të orientohen me fokus të rinjtë, sidomos për vajzat që bëhen nëna për herë të parë, për të mundësuar përdorimin nga ana e tyre të shërbimeve para lindjes, kujdesin obstetrik bazë dhe atë të emergjencës, si edhe shërbimet pas lindjes.

MIRËNJOHJE DHE KONTAKTE

Ky dokument faktesh është përgatitur nga Elona Boce Elmazi për UNFPA. Ajo do të donte të falënderonte fëmijët e martuar herët dhe anëtarët e agjensive qeveritare dhe jo-qeveritare që morën pjesë në intervista. Një falenderim i veçantë shkon për stafin e zyrës rajonale të UNFPA-EECARO dhe ekipin e UNFPA Shqipëri, të cilët e këshilluan dhe e mbështetën gjatë procesit. Më tej, ajo do të donte të falënderonte Damir Barisq, drejtuesin e ekipit për Evropën Juglindore, Joanna Hoare, redaktore dhe Blanka Hancilova nga UNFPA EECCARO.

UNFPA Shqipëri: Rr. "Skenderbe", Ndertesa Gurten (Volkswagen), kati 2, Tiranë, Shqipëri

UNFPA EECCARO: Hakki Yeten Caddesi, Selenium Plaza, No:10/C Kat 18-19, 34349 Besiktas, Istanbul, Turkey; eecaro@unfpa.org

Tetor 2012, Version 1



Për një botë ku çdo shtatzëni është e dëshiruar, lindja e çdo fëmije është e sigurtë dhe potenciali i çdo të riu përmbushet.